



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Leje Ndërtimore





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS



OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/02-32277

Dt. 02.07.2025

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031 dhe Harta Zonale Komunale me Nr.011/01-1392 e datës 31.01.2024, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, lëshon këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Arsim (Ali) Rexha nga fshati Moglicë Komuna e Gjakovës		
Adresa:	Fshati Moglicë Komuna e Gjakovës		
Telefoni:	044 133 811	Emaili:	

Emri i Projektit:	Ndërtimi i kompleksit të banimit individual si bllok urbanistik, me destinim objekte të banimit individual në varg, gjithsej 10 shtëpi – , me etazhitet të planifikuara B+P+2 sipas projektit të prezantuar.		
Emri i Projektuesit:	“Land Studio” – SH.P.K		
Adresa:	Rruga “ Perandori Doklician” nr.7 - Prishtinë .		
Telefoni:	049 199 079	Emaili:	



Për punët ndërtimore në vijim:		
Adresa: Fshati Moglicë Komuna e Gjakovës.		
Zona(t) Kadastrale: Moglicë	Nr. i parcelave kadastrale: 00052-2	GPS Koordinatat:

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtim i ri ☒	Rindërtim ☐ Riparim ☐
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I ☒	Kategoria II ☐

Përdorimi i propozuar:	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po ☐ Jo ☒
Përshkrimi: Lejohet Ndërtimi i kompleksit të banimit individual si bllok urbanistik, me destinim objekte të banimit individual në varg, gjithsej 10 shtëpi – , me etazhitet të planifikuara B+P+2 sipas projektit të prezantuar.	

Me këtë vendim, poseduesi i lejes ndërtimore **Arsim (Ali) Rexha** nga Gjakova, i lejohet ndërtimi i kompleksit të banimit individual si bllok urbanistik, me destinim objekte të banimit individual në varg, gjithsej 10 (dhjetë) shtëpi – , me etazhitet të planifikuara B+P+2 sipas projektit të prezantuar me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) për ndërtim **S= 5241.71 m²**.

Shtëpia 1.

Bodrumi: (Sip,Bruto): S= 146.95 m²
Përdhesa: (Sip,Bruto): S= 112.00 m²
Kati i parë: (Sip,Bruto): S= 122.50 m²
Kati i dytë: (Sip,Bruto): S= 122.50 m²

Shtëpia 2.

Bodrumi: (Sip,Bruto): S= 145.37 m²
Përdhesa: (Sip,Bruto): S= 110.80 m²
Kati i parë: (Sip,Bruto): S= 121.19 m²
Kati i dytë: (Sip,Bruto): S= 121.19 m²

Shtëpia 3.

Bodrumi: (Sip,Bruto): S= 158.96 m²
Përdhesa: (Sip,Bruto): S= 113.20 m²
Kati i parë: (Sip,Bruto): S= 123.81 m²
Kati i dytë: (Sip,Bruto): S= 123.81 m²

Shtëpia 4.

Bodrumi: (Sip,Bruto): S= 154.90 m²
Përdhesa: (Sip,Bruto): S= 113.20 m²
Kati i parë: (Sip,Bruto): S= 123.81 m²
Kati i dytë: (Sip,Bruto): S= 123.81 m²

Shtëpia 5.

Bodrumi: (Sip,Bruto): S= 139.07 m²
Përdhesa: (Sip,Bruto): S= 110.80 m²
Kati i parë: (Sip,Bruto): S= 121.19 m²
Kati i dytë: (Sip,Bruto): S= 121.19 m²

Shtëpia 6.

Bodrumi: (Sip,Bruto): S= 195.77 m²
Përdhesa: (Sip,Bruto): S= 112.00 m²
Kati i parë: (Sip,Bruto): S= 122.50 m²
Kati i dytë: (Sip,Bruto): S= 122.50 m²

Shtëpia 7.

Bodrumi: (Sip,Bruto): S= 201.27 m²
Përdhesa: (Sip,Bruto): S= 108.00 m²
Kati i parë: (Sip,Bruto): S= 144.37 m²
Kati i dytë: (Sip,Bruto): S= 144.37 m²

Shtëpia 8.

Bodrumi: (Sip,Bruto): S= 179.37 m²
Përdhesa: (Sip,Bruto): S= 116.00 m²
Kati i parë: (Sip,Bruto): S= 126.87 m²
Kati i dytë: (Sip,Bruto): S= 126.87 m²

Shtëpia 9.

Bodrumi: (Sip,Bruto): S= 167.96 m²
Përdhesa: (Sip,Bruto): S= 116.00 m²
Kati i parë: (Sip,Bruto): S= 126.87 m²
Kati i dytë: (Sip,Bruto): S= 126.87 m²

Shtëpia 10.

Bodrumi: (Sip,Bruto): S= 129.63 m²
Përdhesa: (Sip,Bruto): S= 108.00 m²
Kati i parë: (Sip,Bruto): S= 118.12 m²
Kati i dytë: (Sip,Bruto): S= 118.12 m²

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informatat mbi projektuesin

- informata mbi kontraktuesin
- prezantimi grafik i dukjes se ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me të gjitha faza për nevojat e realizimit të ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - protokollet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzoj njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesit: **Arsim (Ali) Rexha** nga fshati Moglicë Komuna e Gjakovës përmes kërkesës së evidentuar me nr. 07-351/02-32277 të datës dt. 24.06.2025, të parashtruar DUMM-së, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin e objekteve të kategorisë së parë, me etazhitet të planifikuar B+P+2, në parcelen kadastrale me numër: 00052-2, ZK: Moglicë, në pronësi të lartë përmendurit.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031 dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Plani i Situacionit 1: 1000 i vërtetuar nga DUMM, dt. 19.05.2025
- Kopjen e planit (fotokopje) së bashku me Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme (fotokopje) me numër të lëndës 1006-25 të datës 01.04.2025, në pronësi të **Arsim (Ali) Rexha 1/1** nga Gjakova të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë.
- Aktvendimin e Kushteve Ndërtimore me nr. 07-351/02-21430 të datës 20.05.2025.

- Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, nr. 433 të datës 19.06.2025.
- Pëlqimin nga K.R.U. "Gjakova" Sh.A. Gjakovë, nr. 2045 të datës 17.06.2025.
- Pëlqimin nga Vala Telekomit i Kosovës, nr. 71 të datës 05.06.2025.
- Pëlqimi nga KRM "ÇABRATI" nr. 1759 të datës 10.06.2025.
- Pëlqimin nga IPKO, nr. 561 të datës 02.06.2025.
- Pëlqimin nga TELKOS datë 09.06.2025
- Pëlqimi për shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore me nr. 08-320/01-33274 të datës 02.07.2025.
- Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Banka Credins Kosovë Filiali në Gjakovë me datë 30.06.2025.
- Projektin kryesor, në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga "Land Studio" – SH.P.K - Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 22159.88 Euro.

- **Shtojcë:** Lejes së ndërtimit i bashkëngjitet: Plani i Situacionit së bashku me kushte lokacioni, me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, në përpjesë 1:1000 të datës 19.05.2025, të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim.

Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Nga një kopje të këtij vendimi t'i dërgohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë për Punë Inspektuese,
- Arkivit.

Zyrtari përgjegjës për lëndë

Agron Gojani – I.D.A.

